

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE – BERAT

**STRATEGJIA E MENAXHIMIT
TË RISKUT**

**KOORDINATOR RISKU
ERILA BEBI**

DREJTORI DRTK BERAT

BORA ALIAJ

JANAR, 2026

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. BAZA LIGJORE DHE METODIKE.....	3
III. PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME	3
IV. DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT	4
V. QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT.....	4
VI. PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT	4
VII. PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT	5
VIII. VLERËSIMI I RISKUT.....	5
IX. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	5
ANEKS 1 – REGJISTRI I RISKUT (FORMAT STANDARD).....	6
ANEKS 2 – RISKET PRIORITARE: MASA, AFATE, PËRGJEGJËSI.....	8
ANEKS 3 – PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË.....	10

I. HYRJE

DRTK Berat, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), harton Strategjinë e Menaxhimit të Riskut si dokument udhëzues për identifikimin, vlerësimin, trajtimin dhe monitorimin e risqeve që mund të ndikojnë arritjen e objektivave institucionale. Dokumenti synon të forcojë kontrollin e brendshëm, të rrisë llogaridhënien menaxheriale dhe të sigurojë përdorimin efficient të burimeve.

Kjo strategji është e përshtatur për kontekstin operacional të DRTK Berat, duke marrë në konsideratë rolin e saj në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale, përfshirë pasuritë dhe zonat me vlera të veçanta (p.sh. qendra historike dhe pasuri me status të mbrojtur), proceset e inspektimit/monitorimit, shërbimet teknike (mendime teknike, verifikime në terren), administrimin e arkivës dhe bashkëpunimin me palët e interesuara.

II. BAZA LIGJORE DHE METODIKE

Baza ligjore dhe metodike për hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie përfshin, ndër të tjera:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe aktet nënligjore përkatëse;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

III. PËRKUFIZIME DHE PËRCAKTIME

- Risku: efekti i pasigurisë në arritjen e objektivave; mund të ketë pasoja negative ose pozitive.
- Vlerësimi i riskut: procesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut për të përcaktuar pranueshmërinë e tij.
- Zotëruesi i riskut: personi me autoritet dhe përgjegjësi për administrimin e riskut në fushën e tij.
- Kontrolle: politika, procedura dhe masa që reduktojnë probabilitetin dhe/ose ndikimin e një risku.
- Riski i mbetur: niveli i riskut pas aplikimit të kontrolleve ekzistuese dhe/ose masave trajtuese.

IV. DEKLARATA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

DRTK Berat angazhohet të sigurojë që risqet identifikohen dhe trajtohen me përgjegjësi të përcaktuar dhe në kohën e duhur. Në përmbushje të kësaj politike:

- drejtuesi monitoron dhe verifikon periodikisht risqet që kërcënojnë objektivat strategjikë;
- përgjegjësit e riskut sigurojnë kapacitetet e nevojshme për identifikim, vlerësim, adresim dhe raportim;
- trajnimi i stafit mbi metodikën e menaxhimit të riskut konsiderohet detyrim institucional;
- raportimi i ngjarjeve pozitive/negative është detyrim i çdo punonjësi;

V. QËLLIMI I POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut është identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi ose reduktimi i tij në një nivel të pranueshëm, duke kufizuar kostot sociale dhe financiare në minimumin e domosdoshëm. Menaxhimi i riskut shërben si komponent i rëndësishëm i sistemit të kontrollit të brendshëm, siguri e arsyeshme për arritjen e objektivave, garanci për shërbime më të mira publike dhe mbështetje për vendimmarrje më të besueshme.

VI. PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT

Parimet e menaxhimit të riskut të DRTK Berat mbështeten në komponentët e kontrollit të brendshëm (mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi/komunikimi dhe monitorimi). Këto parime përkthehen në:

- integritet dhe vlera etike; ndarje rolesh dhe linja raportimi të qarta;
- objektiva të matshme si bazë për identifikim dhe vlerësim risqesh;
- aktivitete kontrolli të dokumentuara (procedura, lista verifikimi, autorizime, ndarje detyrash);
- komunikim të brendshëm/ të jashtëm të standardizuar dhe të gjurmueshëm;
- monitorim periodik, auditim të brendshëm (kur aplikohet) dhe trajtim të mangësive.

VII. PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Plani i menaxhimit të riskut në DRTK Berat ndjek ciklin: Identifikim -Analizë -Adresim-Monitorim/Kontroll. Procesi organizohet sipas qasjes së vetë-vlerësimit të riskut nga çdo sektor, me raportime periodike.

Në nivel praktik, për çdo risk përcaktohen: fusha e veprimtarisë, burimi i riskut, përshkrimi (ngjarja-pasoja -impakti), niveli para kontrollit (ndikim/probabilitet), kontrollet ekzistuese, masa të planifikuara, përgjegjësi dhe afate.

VIII. VLERËSIMI I RISKUT

Vlerësimi i riskut realizohet duke kombinuar probabilitetin e ndodhjes dhe ndikimin (impaktin) në rast materializimi. Për lehtësim, përdoret kategorizimi: i lartë / mesatar / i ulët. Si orientim: probabilitet i lartë (>70%), mesatar (30-70%), i ulët (<30%). Për secilin risk bëhet dallimi midis riskut të natyrshëm dhe riskut të mbetur (pas kontrolleve).

IX. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Menaxhimi i riskut nënkupton monitorim të vazhdueshëm dhe raportim mbi kushtet e riskut, në mënyrë që:

- të vlerësohet nëse aktivitetet e kontrollit kanë reduktuar risqet;
- të identifikohen risqet që janë bërë më kërcënuese apo janë pakësuar;
- të përditësohet regjistri i riskut dhe plani i masave.

Raportimi rekomandohet të kryhet 1 herë në vit (ose më shpesh për risqe të larta), me përmbledhje për Titullarin si dhe me dokumentim të veprimeve korrigjuese kur evidentohen mangësi.

ANEKS 1 – REGJISTRI I RISKUT (FORMAT STANDARD)

Regjistri i riskut është mjeti ku depozitohen të dhënat mbi risqet e identifikuar, seriozitetin e tyre dhe veprimet për adresimin e tyre.

Nr.	Fusha	Përshkrimi (ngjarja→pasoja→impakti)	Ndikim	Prob.	Kontrolle ekzistuese	Masa të planifikuara	Përgjegj ës	Afat
R1	Menaxhim/Planifikim	Mungesë e planifikimit të integruar për ndërhyrjet në pasuri kulturore/ vonesa/ ndërhyrje jo prioritare.	Lartë	Mesatar	Plan pune vjetor; koordinim me MTKS/IKTK.	Përditësim i listës së riskut cdo 6 muaj dhe ndryshime në planin e punës mujor dhe vjetor në bazë të emergjencave.	Përgjegjë s Sektori AAAMT K	6 mujor
R2	Inspektim/Monitorim	Mungesë burimesh për monitorim në terren (transport/personel)/kontrolle pamjaftueshme/degradim/ndërtime të paligjshme.	Lartë	Lartë	Plan monitorimi; raportime; bashkëpunim me Bashkinë/IKMT/ Policinë.	Kërkesë sigurim mjete/karburant; lista verifikimi.	P.Sek AAAMT K dhe P.Sek Financë dhe Shërbime ve Mbështetëse	6 mujor
R3	Prokurime/ Konkurim/ Investime/	Vonesa në procedura prokurimi nga subjekte me oferta fiktive/ Mungesë operatorësh të interesuar për marrjen pjesë në procedura konkurimi për restaurim objektsh	Mesatar	Mesatar	Dosje standarde; kontrolle ligjore; transparencë.	Trajnim prokurimesh; Pasurimi i procedurave të prokurimit me specifikimet teknike të duhura/Kërkesë për akordim fondesh shtesë për investime në pasuri kulturore	Sektori Financës dhe Shërbime ve Mbështetëse	Vjetor
R4	UNESCO/Qendra historike	Presion zhvillimor dhe ndërtime pa leje në zonën e	Lartë	Mesatar	Koordinim me IKTK; verifikime; akte konstatimi.	Intesifikim monitorimi; mekanizëm raportimi i	Sektori i AAAMT K	Mujor

		mbrojtur /rrezik për integritetin e pasurisë				shpejtë; forcim bashkëpunimi me bashkinë dhe institucione që mbrojnë territorin.		
R5	Emergjenca/Natyrore	Tërmete, zjarre, përmytje / dëmtime strukturore në monumente.	Lartë	Mesatar	Monitorim në terren/ Kontakte me emergjencat civile/bashki/prefekturë.	Përditësimi i listës së kontakteve për emergjencat civile/	Drejtoria	Vjetor
R6	Arkivë/Dokumentacion	Humbje/dëmtim dokumentacioni teknik (fizik).	Lartë	I Ulët	Regjistër protokoll; ruajtje fizike.	Digjitalizim i arkivës.	Arkiva	12 muaj
R7	Burime njerëzore	Mungesë personeli të kualifikuar(restaurim, inxhinieri)/cilësi e ulët kontrolli/mbikëqyrje	Lartë	Mesatar	Ndarje detyrash/ kërkesa për mbështetje nga IKTK.	Studim për mundësi trajnimesh/ kërkesë për plotësim organike.	Drejtoria	Vjetor
R8	Financa	Mosmiratim ose kufizim buxheti/ mosrealizim aktiviteteve/monitorimesh/ rritje risku operativ.	Lartë	Mesatar	Planifikim konservativ; prioritizim.	Portofol projektsh gati; kërkesa për fonde shtesë; burime alternative.	Financa + drejtoria	Vjetor
R9	Transparencë/Komunikimi	Vonesa në përgjigje ndaj kërkesave/ ankimime	Mesatar	Ulët	Pikë kontakti; regjistër kërkesash.	Standardizim përgjigjesh; afate; publikim periodik.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit	3 mujor
R10	Konflikt interesi/Etikë	Konflikt interesi ose favorizime/hetime/sanksione.	Lartë	Ulët	Deklarime.	Rotacion detyrash.	Drejtoria	Vjetor

ANEKS 2 – RISKET PRIORITARE: MASA, AFATE, PËRGJEGJËSI

Tabela më poshtë përmbledh risqet prioritare dhe masat kryesore të reduktimit të tyre.

Risk	Prioriteti	Masa kryesore	Indikator monitorimi	Afat	Përgjegjës
R1	Mesatar	Përditësim i listës së riskut cdo 6 muaj dhe ndryshime në planin e punës mujor dhe vjetor në bazë të emergjencave.	Raport / evidencë zbatimi	6 mujor	Përgjegjës Sektori AAAMTK
R2	Lartë	Kërkesë sigurim mjeti/karburant; lista verifikimi.	Evidencë zbatimi	6 mujor	P.Sek AAAMTK dhe P.Sek Financë dhe Shërbimeve Mbështetëse
R3	Mesatar	Trajnim prokurimesh; Pasurimi i procedurave të prokurimit me specifikimet teknike të duhura/Kërkesë për akordim fondesh shtesë për investime në pasuri kulturore	Evidencë zbatimi	Vjetor	Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
R4	Mesatar	Intesifikim monitorimi; mekanizëm raportimi i shpejtë; forcim bashkëpunimi me bashkinë dhe institucione që mbrojnë territorin.	Raport / evidencë zbatimi	Mujor	Sektori i AAAMTK
R5	Mesatar	Përditësimi i listës së kontakteve për emergjencat civile	Raport / evidencë zbatimi	Vjetor	Drejtoria

R6	I Ulët	Digjitalizim i arkivës.	Raport / evidencë zbatimi	12 muaj	Arkiva
R7	Mesatar	Studim për mundësi trajnimesh/ kërkesë për plotësim organike.	Evidencë zbatimi	Vjetor	Drejtoria
R8	Mesatar	Portofol projektesh gati; kërkesa për fonde shtesë; burime alternative.	Evidencë zbatimi	Vjetor	Financa + drejtoria
R9	Ulët	Standardizim përgjigjesh; afate; publikim periodik.	Evidencë zbatimi	3 mujor	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
R10	Ulët	Rotacion detyrash.	Evidencë zbatimi	Vjetor	Drejtoria

ANEKS 3 – PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Nr.	Objektiv/Veprim	Përmbajtja	Afati	Përgjegjës
1	Miratimi i Strategjisë dhe komunikimi i brendshëm	Urdhër i Drejtorit; njoftim stafit; publikim në ëeb/arkivë	1 muaj	Drejtori + Koordinator Risku
2	Përditësimi i regjistrit të riskut	Mbledhje sektoriale; vlerësim ndikim/prob.; konsolidim	Vjetor	Koordinator Risku + Sektorët
3	Digjitalizimi i arkivës prioritare	Skanim; backup	12 muaj	Arkiva
4	Plan emergjencash për pasuri prioritare	Harta rreziku; kontakte;	6-12 muaj	Përgjegjës AAAMTK
5	Raportim periodik dhe rishikim	Raport vjetor; rishikim i masave; veprime korigjuese	Vjetor	Koordinator Risku + Drejtoria